

VENDIM
Nr. 415, datë 25.6.2014

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 35, DATË 29.1.2014,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË
PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME PËR VITIN 2014 NË NJËSITË
E QEVERISJES QENDRORE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 11 të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 35, datë 29.1.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

a) “1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2014 në njësitë e qeverisjes qendrore është 865 veta, sipas lidhjeve nr. 1, nr. 2, nr. 3, nr. 4 dhe nr. 5, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.”

b) Pas lidhjes nr. 4 shtohet lidhja nr. 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi, e cila detajon ndarjen e shtesës prej 100 (njëqind) punonjësish, të miratuar me këtë vendim.

2. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi përballohen nga fondet buxhetore dhe nga të ardhurat e siguruara nga ALUIZNI, për vitin 2014.

3. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit të depozitojë pranë Ministrisë së Financave detajimin e numrit të punonjësve, me emërtesën “specialist” dhe “teknik i specialiteteve të ndryshme”, brenda numrit të përcaktuar për çdo drejtori të ALUIZNI-t dhe brenda kriterëve të përcaktuara në vendimin nr. 1703, datë 24.12.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për vendosjen e standardeve të shërbimeve dhe aktiviteteve sezonale/të përkohshme për ministritë dhe institucionet buxhetore.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Gr.	Emri i institucionit	Nr. i punonjësve	Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periudhë kohore
94	Ministria e Zhvillimit Urban dhe Strehimit	100	Specialist/teknik mesëm i	8 orë/ditë	01.07.2014-30.11.2014
	Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana 1	24	Specialist/teknik mesëm i	8 orë/ditë	01.07.2014-30.11.2014
	Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana 2	10	Specialist/teknik mesëm i	8 orë/ditë	01.07.2014-30.11.2014
	Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana 3	29	Specialist/teknik mesëm i	8 orë/ditë	01.07.2014-30.11.2014
	Drejtoria e ALUIZNI-t Durrës	10	Specialist/teknik mesëm i	8 orë/ditë	01.07.2014-30.11.2014
	Drejtoria e ALUIZNI-t Elbasan	6	Specialist/teknik mesëm i	8 orë/ditë	01.07.2014-30.11.2014
	Drejtoria e ALUIZNI-t Korçë	2	Specialist/teknik mesëm i	8 orë/ditë	01.07.2014-30.11.2014
	Drejtoria e ALUIZNI-t Shkodër	5	Specialist/teknik mesëm i	8 orë/ditë	01.07.2014-30.11.2014
	Drejtoria e ALUIZNI-t Lezhë	2	Specialist/teknik mesëm i	8 orë/ditë	01.07.2014-30.11.2014
	Drejtoria e ALUIZNI-t Vlorë	3	Specialist/teknik mesëm i	8 orë/ditë	01.07.2014-30.11.2014
	Drejtoria e ALUIZNI-t Fier	5	Specialist/teknik mesëm i	8 orë/ditë	01.07.2014-30.11.2014
	Drejtoria e ALUIZNI-t Kukës	1	Specialist/teknik mesëm i	8 orë/ditë	01.07.2014-30.11.2014
	Drejtoria e ALUIZNI-t Dibër	1	Specialist/teknik mesëm i	8 orë/ditë	01.07.2014-30.11.2014
	Drejtoria e ALUIZNI-t Gjirokastrë	1	Specialist/teknik mesëm i	8 orë/ditë	01.07.2014-30.11.2014
	Drejtoria e ALUIZNI-t Berat	1	Specialist/teknik mesëm i	8 orë/ditë	01.07.2014-30.11.2014
	Total punonjës me kontratë	100			